

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar i kolegjit, Emine Kaçiku dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit B. V., nga P., të cilën me autorizim e përfaqëson, av. Ad. V., me seli në P., kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMŠHCK), për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.UZH.nr.131/2017 të datës 12.9.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 07.12.2017, mori këtë

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesa e paditësit B. V., për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.UZH.nr.131/2017 të datës 12.09.2017.

II. Anulohen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.131/2017 i datës 12.09.2017 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për çështje administrative A.U.nr.585/2014 i datës 09.02.2017, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosije.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.131/2017 e datës 12.09.2017, është aprovuar ankesa e të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMŠHCK), të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative A.U.nr.585/2014 të datës 09.02.2017, me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit B. V., ndërsa është anuluar Vendimi i të paditurit (KPMŠHC) nr.... të datës ... dhe çështja i është kthyer të paditurit në rishqyrtim dhe rivendosije. Në paragrafin I të aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit është aprovuar ankesa e të paditurit. Në paragrafin II është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Dep.administrativ A.U.nr.585/14 dt.09.02.2017, dhe në paragrafin III është lënë në fuqi Vendimi i KPMŠHC A... dt.....

Paditësi, kësaj Gjykate në afat ligjor i ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën në tërësi e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar, për shkak të shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kontestuar ta ndryshojë, ashtu që të refuzojë si të pabazuar ankesën e të paditurit KPMŠHC dhe të vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.U.nr.585/2014 të datës 09.02.2017.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pretendimet e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.131/2017 dt.12.09.2017 është aprovuar si e bazuar ankesa e të paditurit KPMSHCK, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dep.administrativ A.U.nr.585/14 dt.09.02.2017 me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B. V., ndërsa është anuluar vendimi i të paditurit A....dt....., dhe çështja i është kthyer të njëjtit organ në rivendosje. Në paragrafin I të aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit është aprovuar ankesa e të paditurit (KPMSHC). Në paragrafin II, është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë A.U.nr.585/14 dt.09.02.2017, dhe në paragrafin III të këtij aktgjykimi, është lënë në fuqi vendimi i të paditurit (KPMSHC) A....dt.....

Gjykata Supreme vlerëson se aktgjykimi i kontestuar përmban shkelje të dispozitave të nenit 182 par.2 pika (n) të LPK-së, i zbatueshëm në bazë të nenit 63 të LKA-se. Dispozita e këtij neni përcakton se shkelje thelbësore të dispozitave procedurale ekzistojnë gjithmonë kur aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye, apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit.

Shkeljet thelbësore konsistojnë në faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me arsyet ligjore në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së dytë. Nga përmbajtja e arsyetimit të aktgjykimit të kontestuar, gjykata e shkallës së dytë konstaton gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Në një situatë të këtillë procedurale gjykata e shkallës së dytë është dashtë që t'ia përshtat dispozitës së nenit 195.1 e) të LPK, në të cilën shprehimisht thuhet se gjykata e ankimimit mundet në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes mes tjerash “ ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë”. Në dispozitivin e aktgjykimit kontestues gjykata e shkallës së dytë e aprovon ankesën e të paditurit, pastaj e anulon aktgjykimin e shkallës së parë, refuzon padinë e paditësit dhe e vërteton aktvendimin kontestues administrativ të të paditurit. Dispozita e nenit 195 i LPK në të cilin bazohet aktgjykimit i kontestuar në mënyrë të detajuar dhe tekstualisht përcakton se si do të veprojë gjykata e shkallës së dytë. Nga dispozitivi i aktgjykimit të kontestuar gjykata e shkallës së dytë e anulon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e që ka të drejt, mirëpo neni 195.1 pika b) precizon se nëse prishet aktgjykimi i goditur mund të hidhet poshtë padia dhe është e kuptueshme në cilat raste mund të hidhet padia ose pika c) e këtij neni përcakton se, nëse e prishë aktgjykimin çështjen e kthen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Në rastin konkret

gjkata e shkallës së dytë e refuzoi padinë e paditësit e vërteton aktvendimin e të paditurit, ndërsa në dispozitivë nuk vepron sipas dispozitës së pikës e) të nenit 195.1, të LPK-së, e cila përcakton qartë se gjykata e ankimimit mund ta “ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë”. Nga këto arsye ky dispozitivë është i pa qartë dhe kontradiktor me arsyetimin i cili kryesisht bazohet në këtë situatë procedurale të nenit 201.1 pika b) të LPK, nga se gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar ndryshe shkresat dhe provat nga gjykata e shkallës së parë dhe ka konstatuar gjendje tjetër faktike.

Duke vlerësuar arsyet e mësipërme, Gjykata Supreme e Kosovës nuk mund të pranojë si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, për shkak se aktgjykimet e tyre janë përfshirë me shkelje substanciale të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore, i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, të cilat shkelje drejtpërdrejt kanë pas ndikim në marrjen e vendimit të ligjshëm, si dhe të aplikimit të gabuar të drejtës materiale, andaj aktgjykimet e atakuara doemos është dashur të anulohen.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim ti menjanojë të metat e lartpërmendura, të analizoi dhe me kujdes të bëjë vlerësimin e të gjitha provave lidhur me pretendimet e kërkesës për kompensimin e të ardhurave të paditësit, përmes shqyrtimit dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, si dhe me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale. Andaj duke pasur parasysh vërejtjet e cekura më lartë, kjo gjykatë duhet vendosur për gjithë aspektet e padisë së paditësit në raport me të paditurin KPMSHCK dhe vendimin e nr..... i datës i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës meqenëse i njëjti është marrë në shkallë të parë që paditësit i është mohuar e drejta e kompensimit për kohën sa ka qenë në marrëdhënie pune. Poashtu, kjo Gjykatë duke vendosur për vendimin e të paditurit KPMSHCK A.... të datës, duhet të merr vendimin e duhur duke pasur parasysh arsyet e cekura më lartë.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54 par.2 dhe 3 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
ARJ.UZVP.nr.62/2017, më datë 07.12.2017

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Nebojsha Boriçiq

Përktheu: Ferid Abazi